

PRISHTINA



*KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA*

**DREJTORATI I SHËRBIMEVE PUBLIKE, TRANSPORTIT,
MBROJTJES SË AMBIENTIT DHE I TOKËS NDËRTIMORE**

**R R E G U L L O R E
PËR
TRANSPORTIN RRUGOR
NË TERRITORIN E KOMUNËS SË PRISHTINËS**

Prishtinë, dhjetor 2005

Në bazë të nenit 6 dhe nenit 19.2 të Ligjit për transportin rrugor, nr.2004/1, i fuqizuar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2005/23, të nenit 19, paragrafi 1 (dh) dhe të nenit 40, paragrafi 1 (d) të Statutit të Komunës së Prishtinës, të dt. 16.03.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 29.12.2005 miratoi

**R R E G U L L O R E N
P Ë R
T R A N S P O R T I N R R U G O R
N Ë T E R R I T O R I N E K O M U N Ë S S Ë P R I S H T I N Ë S**

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë Rregullore rregullohet ushtrimi i veprimtarisë së transportit rrugor të udhëtarëve dhe të mallrave në territorin e komunës së Prishtinës (më poshtë komuna); lejimi ose ndalimi i përdorimit të autobusëve publikë në rrugë të caktuara; marrja dhe zbritja e udhëtarëve dhe çështje tjera lidhur me transportin e udhëtarëve; krijimi dhe mbajtja (ruajtja) e regjistrave dhe inspektimi i tyre; transporti i bagazhit të udhëtarëve ose i mallrave të tjera; rregullimi ose ndalimi i transportit të udhëtarëve që qëndrojnë në këmbë; çështja e pajisjeve dhe mjeteve (të brendshme ose të jashtme) të autobusëve publikë; pikat e stacioneve dhe vendndaljet në linjat për autobusë; rregullimi ose ndalimi i shpalljeve, shenjave dhe reklamave, brenda apo jashtë autobusëve publikë.

Neni 2

Kjo Rregullore zbatohet në transportin rrugor të udhëtarëve dhe të mallrave në rrugët publike në territorin e komunës.

Neni 3

Rregullimin dhe organizimin e transportit rrugor të udhëtarëve dhe të mallrave në territorin e komunës e bënë Drejtorati i Shërbimeve Publike, Transportit, Mbrojtjes së Ambientit dhe i Tokës Ndërtimore (më poshtë Drejtorati).

Neni 4

Kuvendi i Komunës së Prishtinës (më poshtë Kuvendi), me propozim të Drejtoratit:

- a. Përcakton politikat e zhvillimit të shërbimeve të transportit, të sigurta, efikase dhe ekonomike brenda territorit të Komunës;
- b. Nxjerr Planin e transportit lokal dhe e ndryshon atë sipas nevojës;
- c. Ndryshon Planin e transportit, jo më vonë se pesë vjet nga data e nxjerrjes së tij;
- d. Publikon Planin apo Planin e ndryshuar dhe një kopje të tij ia dërgon Ministrisë së Transportit dhe të Postë-telekomunikacionit (më poshtë Ministria).

Plani duhet të jetë në përputhshmëri me politikën e zhvillimit të tërësishëm të transportit në Kosovë.

Neni 5

Operatorët e transportit që kryejnë veprimtari transporti në territorin e komunës janë të detyruar:

- a. të përdorin mjete të transportit që janë teknikisht në gjendje të rregullt,
- b. të mbajnë në mënyrë të rregullt regjistrin dhe dokumentet për çdo automjet për veprimtarinë e vet transportuese,
- c. të plotësojnë evidenca statistikore sipas formave të miratuara nga organet përkatëse dhe t'i raportojnë ato sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
- d. të mbajnë dokumentet përkatëse në automjetet transportuese, të parapara sipas Ligjit për transportin rrugor.

Neni 6

Operatori i transportit i cili bënë transportin e rregullt publik, në pajtim me kushtet dhe kapacitetet disponuese të automjeteve, duhet të marrë përsipër transportin e çdo udhëtari apo malli të cilët, sipas rregullave të veçanta, nuk janë të përjashtuar nga transporti.

Neni 7

Veprimtaria e transportit rrugor të udhëtarëve dhe mallrave kryhet në bazë të licencës.

Neni 8

8.1. Operatori i transportit publik të udhëtarëve nuk mund të ushtrojë veprimtarinë para se të pajiset me leje dhe rend të udhëtimit.

8.2. Licenca është e domosdoshme për:

- transportin e rregullt të udhëtarëve,
- transportin taksi të udhëtarëve,
- transportin e mallrave, dhe
- терминалет e mallrave (stacionet e ngarkesave).

8.3. Licenca nuk është e nevojshme për automjetet e ndihmës së shpejtë, të zjarrfikësve, etj.

II. TRANSPORTI RRUGOR I UDHËTARËVE

Neni 9

9.1. Transporti rrugor i udhëtarëve në territorin e komunës ushtrohet si:

- transport urban i rregullt i udhëtarëve me autobusë dhe
- transport taksi i udhëtarëve.

9.2. Drejtoria është përgjegjëse për koordinimin dhe rregullimin e transportit urban të rregullt të udhëtarëve me autobusë dhe transportin taksi të udhëtarëve.

Neni 10

10.1. Transporti i rregullt i udhëtarëve me autobusë kryhet në relacione të caktuara (linja) sipas rendit të udhëtimit, të përcaktuar dhe të vërtetuar më parë, çmimit të caktuar e të shpallur dhe kushteve të tjera të transportit.

10.2. Linjat të cilat lidhin dy e më tepër vendbanime në territorin e komunës, janë linja komunale.

Neni 11

11.1. Kuvendi, me propozim të Drejtorisë, miraton rrjetin e linjave urbane dhe numrin e orareve në to.

11.2. Komuna mund të lidhë marrëveshje me komunat tjera për rregullimin reciprok të transportit të udhëtarëve. Marrëveshja është e plotëfuqishme nëse aprovohet nga Ministria.

Neni 12

12.1. Rendi i udhëtimit është akt me të cilin përcaktohen elementet për ushtrimin e veprimtarisë së transportit të rregullt në transportin rrugor, në territorin e komunës, i cili përmban:

- emrin e transportuesit,
- relacionin,
- llojin e transportit,
- radhitjen e vendndaljeve dhe largësinë e tyre nga pika fillestare,
- kohën e nisjes dhe kohën e arritjes në çdo stacion dhe vendndalje,
- periudhën kohore në të cilën mbahet linja,
- afatin e vlefshmërisë së rendit të udhëtimit.

12.2. Rendi i udhëtimit vlen një vit.

Neni 13

Transportuesi është i obliguar që transportin t`a kryen në mënyrë të rregullt dhe sipas rendit të udhëtimit, të vërtetuar dhe të regjistruar.

Neni 14

14.1. Transportuesi obligohet që ta fillojë veprimtarinë e transportit të rregullt urban të udhëtarëve në afat prej 3 ditësh, nga dita e fuqizimit të rendit të udhëtimit, dhe atë nuk mund ta ndërpres përderisa zgjat afati i rendit të udhëtimit.

14.2. Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, transportuesi mund përkohësisht të ndërpresë veprimtarinë, si rezultat i kushteve të jashtëzakonshme të cilat pamundësojnë ushtrimin e veprimtarisë së transportit të rregullt urban.

14.3. Për ndërprerjen, nga paragrafi 2 i këtij neni, transportuesi është i obliguar që të bëjë kërkesë në drejtoratin, i cili do të lëshojë vendim për pranim apo refuzim të kërkesës së transportuesit.

14.4. Transportuesi nuk mund ta ndërpret (pezullojë) veprimtarinë e transportit të rregullt urban në linjë, sipas rendit të udhëtimit të regjistruar dhe të vërtetuar pa lejen e Drejtoratit.

Neni 15

15.1. Transportuesi rendin e udhëtimit nuk mund ta tjetërsoj, e as ta jep me qira.

15.2. Transferimin e rendit të udhëtimit e benë vetëm Drejtorati.

15.3. Emri i transportuesit, i shënuar në rendin e udhëtimit, duhet të jetë i njëjtë me atë të shënuar në librezën e qarkullimit të autobusit dhe në dokumentet tjera përcjellëse të autobusit.

Neni 16

16.1. Drejtorati do të revokojë rendin e udhëtimit në kushtet kur:

- në afat prej 3 ditësh, nga dita e fuqizimit, nuk e fillon ushtrimin e veprimtarisë;
- brenda një muaji kalendarik, pa miratimin e Drejtoratit nuk benë nisjen 3 herë;
- bënë ndërprerje të kohëpaskohshme të mbajtjes së nisjes, respektivisht kur 12 herë brenda afatit të zgjatjes së rendit të udhëtimit nuk mban nisjen pa miratimin e Drejtoratit.

16.2. Linjat dhe nisjet e revokuara do të konsiderohen si të lira, dhe të njëjtat i nënshtrohen procedurës për ndarjen e tyre.

16.3. Operatori i transportit është i obliguar që ndryshimin e rendit të udhëtimit dhe të drejtimit të transportit, ndaljen e përkohshme apo të përhershme të transportit, paraprakisht të miratuar nga Drejtorati, në linjën e lejuar, ta shpallë përmes shtypit apo një mjeti tjetër të informimit.

Neni 17

17.1. Transportuesi bën kërkesë për caktimin e çmimit. Çmimoren e miraton Drejtorati i Ekonomisë. Çmimorja duhet të vendoset në autobusin që qarkullon në atë linjë.

17.2. Personeli i autobusit merr pagesën për shërbime vetëm në bazë të çmimores, nga paragrafi 1 i këtij neni.

Neni 18

Çdo udhëtar në autobus duhet të pajiset me biletë, përveç personave me aftësi përherë dhe plotësisht të kufizuara. Bileta mund të blihet në autobus apo vende të tjera, tek të cilat transportuesi ka besuar shitjen e tyre.

Transporti i veçantë

Neni 19

19.1. Transport i veçantë i udhëtarëve është transporti i grupeve të caktuara të udhëtarëve, duke përjashtuar udhëtarët tjerë, në relacion të caktuar dhe në bazë të lejes së veçantë.

Me transport të veçantë të udhëtarëve kryhet transporti i:

- nxënësve të shkollave fillore, nga vendbanimi deri të shkolla dhe anasjelltas dhe
- punëtorëve, nga vendbanimi deri në punë dhe anasjelltas.

19.2. Lejet për transport të veçantë lëshohen në bazë të Kontratës, e cila duhet të ketë:

- relacionin,
- listën e udhëtarëve,
- çmimin e transportit, vendet për marrje dhe zbritje të udhëtarëve, dhe
- kohën, gjatë së cilës kryhet transporti.

19.3. Kontratën e bënë transportuesi, paraprakisht i licencuar nga Ministria, dhe porositësi i shërbimeve për grupin e udhëtarëve, ku porositësi është njëkohësisht edhe pages i transportit.

19.4. Lejen për transport, sipas këtij neni, e lëshon Drejtorati për Ekonomi me pëlqimin paraprak të Drejtoratit për Shërbime Publike, Transportit. Mbrojtjes së Ambientit dhe Tokës Ndërtimore.

19.5. Leja, sipas këtij neni, nuk përmban rendin e udhëtimit dhe çmimoren.

19.6. Në autobus, në pjesën e përparme, në vend të dukshëm, duhet të jetë mbishkrimi “Transport i veçantë”.

Transporti për nevoja personale

Neni 20

20.1. Operatori transportues, personi tjetër juridik ose fizik dhe qytetari i cili ka automjetin transportues, mund të kryejë transport për nevoja vetjake dhe atë transportin e punëtorëve të vet, ose personave tjerë që kanë të bëjnë me kryerjen e veprimtarisë së vet, si dhe transportin e anëtarëve të familjeve të punëtorëve kur shkojnë në pushim apo rekreacion.

20.2. Transport i udhëtarëve për nevoja personale, në kuptim të kësaj Rregulloreje, konsiderohet edhe transporti i personave të cilin e bëjnë:

1. ndërmarrjet hoteliere, personat tjerë juridikë dhe fizikë të cilët kryejnë veprimtari hoteliere,
2. institucionet shëndetësore, si dhe ato të mbrojtjes sociale që bartin të sëmurit,
3. agjencitë turistike, personat tjerë juridikë e fizikë të cilët kryejnë veprimtari turistike ku, në bazë të kontratës së veçantë të transportit, transportojnë grupe turistësh pa pranimin dhe zbritjen e udhëtarëve gjatë rrugës,
4. shoqatat kulturore, sportive dhe shoqatat tjera që transportojnë nxënës, studentë, personel mësimor ose anëtarë të vet,
5. autoshkollat të cilat aftësojnë kandidatët për vozitës gjatë punës së tyre,
6. operatorët transportues ose punëtorët të cilët kryejnë shërbime të veçanta,
7. operatorët për shërbime të aeroportit ose shoqatat tjera të shërbimeve të aeroportit, nëse kryejnë transportin e udhëtarëve, nga vendnisja e tyre deri të aeroporti dhe anasjelltas.

Neni 21

21.1. Në autobusin me të cilin kryhet transporti për nevojat personale, duhet të jetë i plotësuar regjistri i punëtorëve ose i personave tjerë, i vërtetuar nga pronari (transportuesi), ose ndonjë dëshmi tjetër për të drejtën e transportit të këtyre punëtorëve ose personave.

21.2. Në këndin e djathtë, të poshtëm, të xhamit mbrojtës të autobusit me të cilin kryhet transporti i udhëtarëve për nevoja personale, vendoset mbishkrimi "Transport për nevoja personale".

Kushtet për automjetet

Neni 22

22.1. Të gjithë autobusët me të cilët kryhet transporti publik urban i udhëtarëve, duhet të jenë të regjistruar dhe teknikisht në rregull, sipas dispozitave ligjore.

22.2. Autobusi me të cilin kryhet transporti publik urban duhet të ketë:

- të vënë firmën, respektivisht emërtimin e transportuesit, në pjesën anësore,
- numrin e linjës me kohën e nisjes dhe kohën e arritjes, ose intervalin e lëvizjes në stacionin e fundit, të vënë në këndin e poshtëm të djathtë të xhamit mbrojtës
- orarin e udhëtimit dhe çmimoren e transportit, të vënë në vend të dukshëm dhe mbishkrimin për ndalimin e pirjes së duhanit.

22.3. Autobusi duhet të plotësojë të gjitha kushtet higjieno - teknike të përcaktuara me ligj.

22.4. Kur autobusi nuk ben transportin e rregullt të udhëtarëve, në këndin e majtë të xhamit mbrojtës vihet mbishkrimi përkatës "Garazh" apo "Defekt".

22.5. Në sezonin e dimrit, para daljes në mbajtje të linjës, autobusi duhet të ngrohet.

Neni 23

Transporti publik urban i udhëtarëve në trafikun linjor kryhet me linja të përhershme, me të cilat transporti kryhet për çdo ditë dhe gjatë tërë vitit, apo në periudhë të caktuar të vitit.

Neni 24

Linjat e përhershme të transportit publik urban dhe urbano-periferik të udhëtarëve hapen në përputhje me Planin e transportit lokal.

Neni 25

25.1. Hyrja dhe dalja e udhëtarëve behët vetëm në stacionet e autobusëve dhe në vendndaljet e destinuara dhe të regjistruara në rendin e udhëtimit.

55.2. Transportuesi është i obliguar të ndalet në të gjitha vendndaljet të cilat i ka të regjistruara në rendin e udhëtimit.

Neni 26

Licencën për stacione që janë të destinuara për kryerjen e shërbimeve të transportit urban e lëshon Drejtorati.

Neni 27

Stacionet dhe vendndaljet e autobusëve në linjat e përhershme i cakton me plan Drejtorati.

Neni 28

28.1. Stacionet dhe vendndaljet në linjat urbane dhe urbano-periferike duhet të jenë të rregulluara dhe të shënuara, doemos duhet të kenë sipërfaqe përkatëse të trafikut për ndaljen e automjetit, sipërfaqen për hyrjen dhe daljen e udhëtarëve dhe shenjat e stacionit.

28.2. Në rrugët publike, sipërfaqja për ndaljen e automjetit parimisht duhet të jetë e ndërtuar jashtë shiritit të rrugës, në pjesë të ndarë të rrugës.

28.3. Sipërfaqja e cila shfrytëzohet për hyrjen dhe daljen e udhëtarëve nga automjeti, në rrugë apo në vendbanim, duhet të jetë e shtruar me asfalt, pllaka ose e betonuar.

Neni 29

29.1. Për rregullimin e stacioneve dhe vendndaljeve, mirëmbajtjen dhe vendosjen e shenjave kujdeset Drejtorati.

29.2. Drejtorati mund të bënë shkëputjen ose transferin e stacionit dhe të vendndaljes, nëse kjo është në interes të organizimit më të mirë dhe të sigurisë në trafik.

Neni 30

Stacioni apo vendndalja në linjat në të cilat intervali i qarkullimit është më i gjatë se 15 minuta, duhet të kenë nënpullazet.

Rregullsia e automjeteve

Neni 31

31.1. Automjetet me të cilat behët transporti rrugor i udhëtarëve dhe mallrave në trafikun urban dhe urbano-periferik, duhet t'i plotësojnë kushtet teknike dhe tekniko-shfrytëzuese të rregullsisë së automjeteve.

31.2. Automjetet duhet të kenë urdhëresëudhëtimin, të nënshkruar dhe të plotësuar në mënyrë të rregullt.

Neni 32

32.1. Çdo automjet në transportin rrugor të udhëtarëve në trafikun urban dhe urbano-periferik duhet të jetë i pajisur me aparat zjarrfikës funksional, barnatore manuale dhe çekiçi për thyerjen e xhamave në rast rreziku.

32.2. Në pjesën e brendshme të automjeteve duhet të vendosen mbishkrimet e rëndësishme për rendin në automjet, ulëset për kategoritë e veçanta të udhëtarëve, shenjat e dyerve të hyrjes dhe të daljes.

32.3. Në automjetet e transportit rrugor të udhëtarëve ndalohet vendosja e fotografive dhe objekteve të tjera me karakter pornografik.

Rendi në stacione, vendndalje dhe në automjet

Neni 33

33.1. Automjetet patjetër ndalen në të gjitha stacionet, përkatësisht vendndaljet e linjave të tyre.

33.2. Nëse automjeti nuk ka vende të lira, personeli i automjetit ka për detyrë të njoftojë udhëtarët për këtë.

Neni 34.

34.1. Sinjalin për nisjen dhe ndaljen e automjetit e jep personeli i automjetit.

34.2. Vetëm personeli i automjetit hap dhe mbyll dyert e automjetit.

34.3. Personeli i automjetit nuk guxon të japë shenjë për nisje deri sa të konstatojë se janë mbyllur dyert për hyrje dhe për dalje të udhëtarëve.

Neni 35

Personeli i automjetit ka për detyrë që gjatë orarit të punës të mbajë rrobat (uniformen) zyrtare dhe ndaj udhëtarëve të ketë sjellje korrekte.

Neni 36

36.1. Udhëtarët hyjnë në automjet në dyert e shënuara për hyrje dhe zbresin në dyert e shënuara për dalje.

36.2. Personat me aftësi të kufizuara fizike, gratë shtatzëna, personat me fëmijë deri në 5 vjeç, inspektorët e trafikut, policët në uniformë dhe personat me autorizime të veçanta, mund të hyjnë në dyert e daljes.

Neni 37

37.1. Për shfrytëzimin e shërbimeve të transportit, udhëtari duhet të ketë biletën e udhëtimit, biletën e parapagimit apo leje tjetër valide të udhëtimit.

37.2. Udhëtari është i obliguar që me kërkesën e personit të autorizuar, të tregojë biletën përkatëse të udhëtimit.

Neni 38

Transportuesi në trafikun publik urban dhe urbano-periferik të udhëtarëve është i obliguar që të japë biletën e udhëtimit, në bazë të së cilës udhëtari fiton të drejtën për udhëtim, si dhe biletën e bagazhit, nëse paguhet kompensim i veçantë për të.

Neni 39

39.1. Udhëtari i cili është gjetur, përkatësisht që gjendet pa biletë udhëtimi në automjet, është i obliguar që me kërkesë të personit të autorizuar, të bëjë kompensimin e biletës dhe gjobën në lartësi të dhjetëfishit të çmimit të biletës.

39.2. Nëse udhëtari refuzon të bëjë pagesën, nga paragrafi paraprak, detyrohet që personit të autorizuar t'i japë të dhënat e sakta për identitetin e vet.

Neni 40

Drejtuesi i automjetit është i obliguar të respektojë itinerarin e linjës, të cilin duhet t'a ketë në automjet.

Neni 41

41.1. Drejtuesi i automjetit në transportin linjor të udhëtarëve nuk mund të ndalë-parkojë automjetin në stacionin e nisjes, më gjatë se 10 minuta.

41.2. Drejtuesi i automjetit nuk mund të nisë automjetin para se të ketë vërtetuar se janë mbyllur dyert e hyrjes dhe të daljes.

41.3. Derisa automjeti është në lëvizje, dyert duhet patjetër të jenë të mbyllura.

Neni 42

42.1. Udhëtari i cili dëmton apo e ndot automjetin, është i detyruar të kompensojë dëmin, përkatësisht të paguajë pastrimin e tij.

42.2. Nëse udhëtari refuzon të bëjë kompensimin, përkatësisht pagesën, nga paragrafi paraprak, është i detyruar që personelit të automjetit t'i japë të dhënat e sakta për identitetin e vet.

Neni 43

43.1. Udhëtari mund të futë në automjet: bagazhin e dorës, karrocën e mbledhur të fëmijëve, pushkën e gjahut ose të sportit me këllëf, skitë dhe kompletin për peshkim.

43.2. Në automjet, në pjesën ndihmëse, mund të futen qentë zyrtarë dhe qentë ciceron të personave të verbër, me shportë në turi.

Neni 44

44.1. Gjërat e gjetura në automjet i dorëzohen personelit të automjetit i cili, për këtë lëshon vërtetim me përshkrimin e shkurtër të sendeve të gjetura. Nëse pronari i sendeve të gjetura nuk gjendet gjatë vozitjes, personeli i automjetit ato ia dorëzon menjëherë shërbimit përkatës të transportuesit.

44.2. Transportuesi detyrohet që sendet e gjetura, në afat prej 7 ditësh, t'ia dorëzojë policisë.

Neni 45

45.1. Në rast të ndërprerjes së trafikut apo prishjes së automjetit, personeli është i detyruar që udhëtarëve t'ua sigurojë daljen e sigurtë nga automjeti.

45.2. Në rastet të prishjes së automjetit, nga paragrafi paraprak, transportuesi detyrohet që udhëtarëve t'ua mundësojë që me të njëjtat bileta të vazhdojnë udhëtimin me automjet tjetër.

Neni 46

NDALOHET:

1. të pengohet personeli i automjetit në kryerjen e detyrës,
 2. pirja e duhanit në automjet,
 3. futja e kafshëve në automjet, përveç në rastet nga neni 43 i kësaj Rregulloreje,
 4. hyrja në automjet me armë.
- 4.1 kjo ndalesë nuk ka të bëjë me rastet nga neni 43 të kësaj Rregulloreje dhe

- personat e autorizuar për bartjen e armëve,
- 4.2 futja në automjet e sendeve të cilat mund të lëndojnë, dëmtojnë, ndotin, shqetësojnë udhëtarët ose dëmtojnë automjetin,
- 4.3 futja në automjet e materialeve ndezëse dhe e mjeteve eksplozive,
- 4.4. hyrja në automjet në gjendje të dehur,
- 4.5. shqetësimi i udhëtarëve me këndim, me muzikë, me britmë, me shprehje e sjellje të papërshtatshme,
- 4.6. hedhja e mbeturinave dhe pështyrja në automjet,
- 4.7. hyrja në automjet në kundërshtim me nenin 34.1 të kësaj Rregulloreje,
- 4.8. hyrja në automjet pas vërejtjes së personelit se nuk ka vende të lira.
Udhëtari i cili edhe pas vërejtjes, kryen ndonjërin nga veprimet nga ky nen, do të largohet nga automjeti.

III. TRANSPORTI RRUGOR I MALLRAVE

Neni 47

47.1. Transporti rrugor i mallrave (më poshtë i quajtur: transporti i mallrave) kryhet si:

- a/ transporti i mallrave për nevoja personale, dhe
- b/ transporti i mallrave me qira dhe pagesë.

47.2. Gjatë transportit të mallrave, operatori në automjet duhet t'i ketë këto dokumente:

- licencën dhe
- fletëngarkesën.

Neni 48

Ndërmarrjet publike komunale të themeluara nga Komuna dhe të formuara me qëllim të kryerjes së shërbimeve publike komunale, nuk do të licencohen

Transporti i mallrave për nevoja personale

Neni 49

49.1. Ndalohet marrja me transport për nevoja personale, pa qenë i regjistruar si transportues për këtë.

49.2. Dispozita e paragrafit paraprak nuk do të zbatohet mbi mbajtësin e licencës për transport të mallrave me qira.

Neni 50

50.1. Emri dhe natyra e biznesit duhet të deklarohen kur të regjistrohet veprimtaria e transportit të mallrave për nevoja personale.

50.2. Regjistrimi nuk do të jetë i efektshëm derisa aplikuesi të tregojë së transporti i mallrave për të cilin është kërkuar regjistrimi, mund të emërohet si transport i mallrave për nevoja personale.

Neni 51

Me rastin e kryerjes së transportit për nevoja personale me automjet mbi 3,5 tonelata të një mase më të madhe të lejuar, në automjet duhet të ketë:

- a. fletëngarkesën dhe
- b. dëshminë nga e cila mund të vërtetohet se është fjala për transportin e mallrave për nevoja personale.

Transporti i mallrave me qira dhe pagesë

Neni 52

52.1. Transporti i mallrave me qira dhe pagesë kryhet në bazë të Kontratës së lidhur në mes të qiradhënësit të automjetit transportues dhe qiramarrësit i cili kontraktin transportin e mallrave.

52.2. Gjatë transportit të mallrave me qira dhe pagesë operatori i transportit në automjet duhet të ketë:

- a. fletëngarkesën dhe
- b. kontratën në mes të qiramarrësit dhe qiradhënësit.

IV. MBIKËQYRJA

Neni 53

53.1. Mbiqyrjen në transportin rrugor urban dhe transportin taksi brenda territorit të komunës, e bënë Drejtorati i Inspektionit-Inspektioni i komunikacionit dhe policia.

53.2. Inspektioni i transportit rrugor është i autorizuar:

1. të bëjë kontrollin e operatorëve të transportit rrugor se a janë duke ushtruar veprimtarinë e vet në pajtim me dispozitat e kësaj Rregulloreje dhe a e ushtrojnë atë në bazë të licencave dhe lejeve, të vërtetojnë identitetin e operatorit transportues, personelit vozitës dhe të personave të tjerë përgjegjës për kryerjen e transportit,
2. të urdhërojë mënjanimin e lëshimeve dhe mungesave në aspektin e plotësimit të kushteve të përcaktuara me këtë Rregullore për kryerjen e transportit të udhëtarëve dhe të mallrave,

3. të përjashtojë nga qarkullimi automjetin me të cilin kryhet transporti në kundërshtim me dispozitat e ligjit dhe të kësaj Rregulloreje, të caktojë vendparkimin, të merr lejen e qarkullimit dhe targat në kohëzgjatje prej 48 orësh.

53.3. Nëse të njëjtit operator të transportit i shqiptohet masa e dënimit për herë të dytë, për shkaqet e përcaktuara në paragrafin 2. pika 3 të këtij neni , automjeti do të përjashtohet nga qarkullimi, në kohëzgjatje deri në 5 ditë.

53.4. Me rastin e përjashtimit të automjetit taksi, merret shenja “TAXI”-“RADIO TAXI” dhe numri i evidencës i regjistrimit të qarkullimit.

53.5. Me kalimin e afatit të shqiptimit të dënimit, nga paragrafi 2 pika 3 dhe paragrafi 3 i këtij neni, inspektori i kthen operatorit dokumentet dhe targat e marra, qoftë vet apo përmes organit i cili ka lëshuar këto.

Neni 54

Kur inspektori përjashton automjetin nga qarkullimi, merr vendim që automjeti i ndaluar të dërgohet në shpenzime të mbajtësit të licencës, në vend të caktuar për këto raste.

Neni 55

55.1. Kundër vendimit të inspektorit komunal për transport rrugor mund t'i ushtrohet ankesa Ministrisë, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së vendimit.

55.2. Ankesa dërgohet përmes Drejtoratit të Inspekcionit - Inspekcionit të transportit rrugor.

55.3. Ankesa nuk e shtynë ekzekutimin e vendimit.

V. SANKSIONET ADMINISTRATIVE

Neni 56

56.1. Me gjobë prej 100 deri në 2.500 €, do të dënohet operatori transportues, përkatësisht personi tjetër juridik apo fizik për kundërvajtje, në qoftë se:

- a. ushtron veprimtarinë e transportit publik urban pa licencë (neni 7),
- b. ushtron veprimtarinë e transportit publik të udhëtarëve pa licencë dhe rend të udhëtimit (neni 8.1.).

56.2. Nëse operatori i transportit, përkatësisht personi tjetër juridik apo fizik bënë përsëritje të kundërvajtjes së njëjtë, përveç dënimit me gjobë, do t'i shqiptohet

edhe masa mbrojtëse e ndalesës së ushtrimit të veprimtarisë së transportit, në kohëzgjatje prej 6 deri në 12 muaj.

Neni 57

57.1. Me gjobë prej 100 deri në 2.500 Euro do të dënohet operatori i transportit, përkatësisht personi tjetër juridik, në qoftë se:

- a. nuk mbanë linjën sipas rendit të udhëtimit të vërtetuar dhe të regjistruar (neni 13),
- b. ndryshon rendin e udhëtimit, ndërpret përkohësisht transportin dhe nuk e paraqet ndërprerjen (neni 14.1.dhe 14.3.),
- c. nëse nuk përcakton çmimoren dhe nuk e vendos atë në autobus apo nuk i përmbahet asaj (neni 17),
- d. bënë transportin e veçantë të udhëtarëve në kundërshtim me nenin 19,
- e. bënë transport për nevoja personale në kundërshtim me nenin 20,
- f. vepron në kundërshtim me nenin 15.1 ,
- g. vepron në kundërshtim me nenin 21,
- h. vepron në kundërshtim me nenin 37.1,
- i. vepron në kundërshtim me nenin 49.1 ,
- j. vepron në kundërshtim me nenin 51,
- k. vepron në kundërshtim me nenin 52.

57.2. Për kundërvajtje të njëjta që transportuesi, përkatësisht personi juridik apo fizik i përsërit, përveç dënimit me gjobë, do t'i shqiptohet edhe masa mbrojtëse e ndalesës së ushtrimit të veprimtarisë së transportit, në kohëzgjatje prej 6 deri në 12 muaj.

Neni 58

58.1. Me gjobë prej 150 deri në 300 Euro do të dënohet operatori i transportit:

- a. nëse personelit të vozitjes nuk ia siguron rrobat (uniformën) zyrtare (neni 35),
- b. nëse nuk vepron sipas dispozitës së nenit 21.

58.2. Për kundërvajtje, nga paragrafi 1 i këtij neni,do të dënohet edhe personi përgjegjës i operatorit të transportit me gjobë prej 75 deri në 120 €

Neni 59

59.1. Me gjobë prej 150 deri në 200 € do të dënohet për kundërvajtje operatori i transportit:

- a. nëse kryen transportin me automjete të cilat nuk i plotësojnë kushtet nga neni 32,

- b. nëse nuk vepron sipas dispozitës së nenit 36,
- c. nëse nuk ia jep biletën e autobusit udhëtarit (neni 38),
- d. nëse kryen transportin e personave, të mallrave apo të kafshëve në kundërshtim me nenin 43,
- e. nëse nuk vepron sipas dispozitës së nenit 44.

59.2. Për kundërvajtje, nga paragrafi 1 i këtij neni, do të dënohet edhe personi përgjegjës i operatorit të transportit me gjobë prej 50 deri në 100 €

Neni 60

Me gjobë mandatore prej 50 € do të dënohet për kundërvajtje udhëheqësi i ekuipazhit të automjetit nëse vepron në kundërshtim me nenin 31.2.,nenin 33,34 dhe 35.

Neni 61

Me gjobë prej 100 deri në 300 € do të dënohet për kundërvajtje transportuesi nëse vepron në kundërshtim me nenin 21.

Neni 62

Me gjobë prej 50 deri në 100 Euro do të dënohet për kundërvajtje udhëtarit nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 37, 39, 42, 43 dhe 46.

Neni 63

Dënimet mandatore për kundërvajtje i shqipton inspektori i komunikacionit.

VI. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 64

Obligohen operatorët e transportit që, në afat prej 6 muajsh prej ditës së hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, të bëjnë harmonizimin e akteve të tyre me dispozitat e kësaj Rregulloreje.

Neni 65

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01 Nr. _____ , më _____ 2005

K R Y E T A R I
Ismet Beqiri